



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
I;borni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 835/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hevzi Xhelili kandidatë për asamble komunale nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur kundër kryesuesit dhe komisionerve të vendvotimit KKV për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hevzi Xhelili kandidatë për asamble komunale nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan.

Arsyetim

Me datën 12.11.2013, Hevzi Xhelili kandidatë për asamble komunale nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjilan ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se në QV në fshatrat Dobërçan, Përlepnice Livoq i ulët, Pogragjë dhe Malishevë janë bërë parregullsi në procesin e numërimit të votave, andaj kërkoj nga PZAP-i që të marrë vendim lidhur me obligimin e QNR-së që ta bej hapjen dhe rinumërimin e 40 kutive nga e tërë komuna të cilat gjenden në karantinë, parashtruesi i ankesës pretendon se është demtuar, thuhet në pretendimet e ankuesit

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

PZAP-i konstatoi se pretendimet e Hevzi Xhelilit kandidatë për asamble komunale nga radhët e PDK-së nuk qëndrojnë ngase nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindse me të cilën mund të vërtetohen pretendimet ankimore. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante , andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 835/2013 më datën 12.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.